



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 01.03.2017

Ref.: 124/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 48-të, të mbajtur më 23 shkurt 2017, mori:

V E N D I M

- I. REFUZOHET kërkesa nr.542/16, dt. 04.10.2016 e BPrAL Kolegji "Dardania" për riakreditim të programeve të studimit:
 - Gjuhë Angleze dhe Studime Amerikane, MA, (120 ECTS);
 - Psikologji Organizative, MA, (120 ECTS);
 - Administrim Publik, MA, (120 ECTS).
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji "Dardania" ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim të programeve të studimit: Gjuhë Angleze dhe Studime Amerikane, MA, (120 ECTS); Psikologji Organizative, MA, (120 ECTS); dhe Administrim Publik, MA, (120 ECTS).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 shkurt 2017 ka vlerësuar aplikacionin e BPrAL Kolegji "Dardania", dhe pas shqyrtimit të dosjes së stafit akademik duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (nr.20/2016, datë 20.09.2016), neni 11, pika 3.2, ku sipas kësaj pike, institucioni duhet të ketë të paktën tre PhD (Dr.sc.) në marrëdhënie të rregullt pune për secilin program studimi, dhe në pajtim me nenin 13, pika 1.1 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim nr.20/2016, datë 20.09.2016, KSHC ka konstatuar që ky aplikacion nuk i përmbush kushtet për aprovim, dhe më këtë rast ka refuzuar aprovimin e aplikacionit për programet e cekura më sipër të BPrAL Kolegji "Dardania".


Pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të ofruar nga BPrAL Kolegji "Dardania", KSHC konstatoj se ka mungesë të stafit akademik me dokumentacion të rregullt për këto programe të studimit me të cilat ka


aplikuar për riakreditim, dhe si rrjedhojë e kësaj gjendje, KSHC mori vendim për refuzim të aplikacionit të BPrAL Kolegji "Dardania" për programet e cekura më sipër.


Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Dardania"
- MASHT;
- Arkivët të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë





KOLEGJI DARDANIA

Rr. "Ibrahim Lutfiu" Nr.17 10000 Prishtinë
Tel: +381 (0) 38 247-587 / +377 (0) 44 636-359
Web: www.kolegjidardania.com



01.Nr.031- 632 më 30.09.2016

PËR: Agjencia e Kosovës për Akreditim, Prishtinë, Qendra e Studentëve, kati II-të

NGA: Prof.Dr.Gjyldane Mulla, rektore e Kolegjit "Dardania" – Prishtinë

LËNDA: Kërkesë për riakreditimin e programeve studimore

Të nderuar,

Kolegji Dardania ka parashtruar kërkesën për ri-akreditimin e programeve studimore të listuara si në vijim:

- 1. Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale (BA)**
Grada akademike: Baccelor i Arteve në Përkujdesje dhe Mirëqenie Sociale,
Niveli: VI, ECTS: 180
- 2. Gjuhë Angleze dhe Studime amerikane (MA)**
Grada akademike: Master i Arteve në Gjuhë Angleze dhe Studime Amerikane,
Niveli: VII, ECTS: 120
- 3. Psikologji Organizative (MA)**
Grada akademike: Master i Arteve në Psikologji Organizative,
Niveli: VII, ECTS: 120
- 4. Administrim Publik (MA)**
Grada akademike: Master i Arteve në Administrim Publik,
Niveli: VII, ECTS: 120

ME NDERIME

PËR: BPrAL Kolegji "Dardania"
Prof.Dr.Gjyldane Mulla, rektore